



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 145

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR QË DO ORGANIZOJË PUNËN
PËR PARAQITJEN E Z. EDUARD MUHAMET NALLBANI, SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA
ZGJEDHËSIT NE ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1332 Prot datë 6.3.2023 me:

Kërkues: 1-Arben Ismaili Mani, 2-Ardian Bajram Bajrami, 3-Nexhmije Shahin Nallbani, 4-Azis Andrea Mefa, 5-Agim Xhaferr Meta, 6- Jorida Mehmet Meta, 7-Etjen Kujtim Cepele, 8-Saimir Haredin Çelaj, 9-Skënder Abedin Elmazaj.

Objekti: Kërkohet regjistrimi i Komitetit Nismëtar, për paraqitjen e z. Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Neni 70 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 Maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në referim të nenit 70, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, grupi i zgjedhësve i përbërë nga 1-Arben Ismaili Mani, 2-Ardian Bajram Bajrami, 3-Nexhmije Shahin Nallbani, 4-Azis Andrea Mefa, 5-Agim Xhaferr Meta, 6-Jorida Mehmet Meta, 7-Etjen Kujtim Cepele, 8-Saimir Haredin Celaj, 9-Skënder Abedin Elmazaj, është drejtuar KQZ-së me

Data: 8.3. 2023 Nr: 145
Ora:11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z Eduard Muhamet Nallbani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

kërkesën me Nr.1332 Prot, datë 6.3.2023, për regjistrimin e Komitetit Nismëtar të formuar prej tyre.

Kërkuesit kanë depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumentave të identifikimit.

Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstratin e përbërësve zgjedhorë rezulton se janë zgjedhës të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, dhe me vullnet të lirë kanë vendosur krijimin e Komitetit Nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin z. Eduard Muhamet Nallbani.

Kërkesa e paraqitur prej këtyre zgjedhësve, përmbush kriterin dhe afatin e përcaktuar në nenin 70, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 70, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI